

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Emine Kaçiku anëtarë, në çështjen juridike të paditëses – kundër të paditurës I. U. e lindur K. nga Prizreni, të cilën e përfaqëson av.R. B. nga Prizreni, kundër të paditurit-kundër paditësit D. K., nga Prizreni të cilin e përfaqëson av.I. M., nga Prizreni ,për shkak të vërtetimit të pronësisë dhe kompensimit , duke vendosur sipas revizionit të paditurit-kundër paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.632/2015 datë 05.05.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20.10. 2016, mori këtë,

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i të paditurit-kundër paditësit D. K., nga Prizreni, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.632/2015 datë 05.05.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.632/2015 të dt.05.05.2016 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit-kundër paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.69/07 i dt.25.09.2014,me të cilin në pjesën e I të dispozitivit, është aprovuar kërkesëpadia e paditëses-kundër së paditurës dhe vërtetohet se paditësja është pronare e pjesës prej 1/5 të paluajtshmërisë parcelës kat.nr..., ZK-...,obligohet i padituri-kundër paditësi të ia kompensojë paditëses kundërvlerën në të holla për paluajtshmërinë në shumë prej 16.948,00€, me kamatën filluar nga dt.12.12.1994 deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të

dhunshëm. Me pjesën e II, është refuzuar si e pabazuar kundër kërkesë padia e të paditurit D. K., dhe me pjesën e III, obligohet i padituri që të ia kompensojë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 2.210€ në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor i padituri-kundër paditësi ka paraqitur revizion , për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni dhe aktgjykimet e instancës më të ulët të prishen.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i të paditurit-kundër paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja është vajza e tani të ndjerëve A. dhe F. K., të cilët kanë patur edhe një vajzë A. M., kurse A. K., ka patur edhe një djalë, tani të ndjerin A., trashëgimtarë të të cilit janë D. dhe Sh. K. Paditësja I., është halla sipas babës e të paditurit D. K. Nëna e paditëses (F.) në emër të vajzave të mitura I., dhe A., me tani të ndjerin A., babain e të paditurit, për ndarjen e trashëgimisë sipas aktvendimit T.nr.99/49 ka arritur lidhjen e Ujdisë Gjyqësore N.nr.66/50 (fotokopja e së cilës është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren, nr.v.2666/95 dt.13.11.1995). Sipas kësaj Ujdie Gjyqësore, nënës së paditëses, paditëses dhe motrës së sajë do t'i takonin dy pjesë të patundshmërisë në fsh..., dhe dy pjesë në ..., kurse, A., babait të së paditurit i kanë takuar tri pjesë të paluajtshmërisë lëndore. Sipas Certifikatës së Shërbimit për kadastrë në Prizren të dt.10.05.1996 ngastrada kadastrale nr..., në v.q.'B..' në të cilën gjendej ndërtesa në sipërfaqe prej 65m² dhe arë e kl.III, në sipërfaqe prej 1.40,59 ha, sipas fletposedimit nr..., ZK-..., deri në v.1992 ka qenë e regjistruar në emër të A. K., babait të paditurit D. Në bazë të aktvendimit T.nr.98/88 dt.7.12.1988 ka kaluar në emër të të paditurit D.K. Ndërsa, i padituri më pas, ngastrën lëndore-paluajtshme rinë kontestuese (nr...), ia ka shitur në tërësi (d.m.th. edhe pjesën kontestuese prej 1/5) blerësit Xh. D., nga K. për çmimin shitblerës prej 50.000-dinarë të atëhershëm, (përkatësishtë 1200-DM për një ari të cilin fakt i padituri nuk e ka

kontestuar), për qfar ka lidhur kontratën e shitblerjes Vr.nr..., dt..., të vërtetuar në gjykatën komunale në Prizren dhe tani evidentohet në emër të blersit Xh. D.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit dhe vlerësimit të provave ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses-kundër të paditurës është e bazuar. Paditësja ka të drejtën pronësore në pjesën prej 1/5 të paluajtshmërisë së sipër cekur në bazë të nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të kësaj marrëdhënie juridike, ku parashihet se e drejta pronësore fitohet me vet ligjin, në bazë të punës juridike dhe në bazë të trashëgimisë. Paditësja si pasardhëse juridike ka fituar këtë të drejtë në bazë të trashëgimisë pas vdekjes së paraardhëses juridike, së ëmës së sajë F. K., dhe atë për pjesën (1/5) e paluajtshmërisë që është objekt i kësajë padie. Ndërkohë që, e tërë kjo paluajtshmëri i është shitur blersit Xh. D., sipas kontratës mbi shitblerjen të v..., të sipër përmendur, ashtu që në kadastrë është bërë bartja dhe kjo evidentohet në emër të blersit, kurse, paditëses nuk i është paguar nga ana e shitësit shuma e caktuar e të hollave për pjesën e cila i takon mbi bazën e trashëgimisë pas vdekjes së të ëmës. Të hollat nga shitja e paluajtshmërisë i ka marrë dikush tjetër, sepse paditësja ka qenë e mitur, kurse në dëftesën e v..., lidhur me pagesën e shumës prej 70.000-din.për paluajtshmërinë e shitur nuk qëndron nënshkrimi i përfaqësueses ligjore të paditëses, së ëmës, si marrëse e të hollave, por marrësi ka qenë me emrin R., Pra, nga deklaratat e dëshmitareve dhe dëftesa e prezantuar, nuk ka mundur të vërtetohet se paditëses i është bërë pagesa e pjesës së të hollave për paluajtshmërinë e shitur, e cila është në shumë prej 16.948€ për 1/5 e kundërvlerës së shumës për të cilën është shitur paluajtshmëria (shih përmbajtjen e shkresave të lëndës). Andaj, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të sajë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses-kundër të paditurës është e bazuar, kurse, kundërpadia e të paditurit-kundër paditësit është e pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare e as me shkelje të tjera të LPK-së, të pretenduara nga revizioni. Dispozitivi i aktgjykimit është i kuartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale dhe materiale nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme e Kosovës ,konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët, përkitazi me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses-kundër të paditurës(pjesa e I e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë) dhe refuzimin e kërkesës së kundërpadisë së të paditurit-kundër paditësit(pjesa e II e dispozitivit), pasi që janë dhënë arsye bindëse dhe të pranueshme edhe nga kjo gjykatë. Prandaj, edhe Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron se aprovimi i kërkesëpadisë së paditëses-kundër të paditurës është i drejtë dhe i ligjshëm, kur kanë vendosur që të obligohet i padituri që paditëses t'i kompensojë 1/5 e kundërvlerës në të holla, për pjesën e paluajtshmërisë së shitur nga i padituri, me që paraprakisht është vërtetuar se paditësja-kundër e paditura e ka fituar të drejtën e pronësisë në 1/5 pjesë ideale të paluajtshmerisë kontestuese në bazë të trashëgimisë (ipso iure) pas vdekjes së ëmës së sajë, të ndjerës F. K.,e cila për të gjallë të vet e sipas Ujdisë së lidhur Gjyqësore N.nr.66/50 (kopja e së cilës e vërtetuar në Gjykatën Komonale në Prizren, me nr.v.2666/95 dt.13.11.1995) i kanë takuar 2/5 pjesë ideale të paluajtshmerisë kontestuese të sipërcekur. Edhe sipas dispozitave të Ligjit mbi Trashëgiminë-LTK-1974 që ishte në fuqi(por edhe sipas dispozitave të LT nr.2004/26, në fuqi),e drejta në trashëgimi fitohet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Kurse, sipas nenit 20 të LMTHPJ-së,e drejta e pronësisë fitohet sipas ligjit, në bazë të punës juridike dhe me trashëgimi, siç është rasti konkret juridiko-civil.

Prandaj, janë të pabazuara pretendimet në revizion, si ai lidhur me ujdinë gjyqësore të lartëcekur, se ajo është pa datë, vulë, etj, për faktin sepse siç rrjedhë nga shkresat e lëndës, kopja e sajë është vërtetuar se është identike me origjinalin e vet(shih vulën katrore dhe të rrumbullakët të Gjykatës Komonale në Prizren nr.v..., dt...,në f.2 të procesverbalit).Edhe pretendimi tjetër

përkitazi me legjitimitetin e paditëses, kjo Gjykatë, konsideron se nuk qëndron, për faktin sepse paditësja si pjesëmarrëse e këtij raporti materialo juridik ,ka legjitimitet real aktiv për të qenë palë paditëse. Sa i përket pretendimit vijues lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, gjithashtu është i pabazuar sepse, e drejta e pronësisë është e drejtë absolute që vepron “erga omnes”,ndërkohë që, paditë për mbrojtjen e pronësisë nuk parashkruhen. Mëtej, në kontekst të pretendimeve tjera të revizionit, me asnjë provë nuk është vërtetuar në mënyrë bindëse se paditëses përkatësisht përfaqësueses së sajë ligjore, së ëmës F. K.,tani e ndjerë, i është paguar nga i padituri shuma për katse e të hollave nga shitblerja e sipërcekur e paluajtshmërisë kontestuese. Poashtu, nuk qëndron as pretendimi i revizionit se i padituri-kundër paditësi ka fituar pronësinë me merëbesim, mbajtje etj, sepse, posedimi nuk ka qenë me mirëbesim, për faktin sepse edhe paraardhësi i të paditurit, por edhe vet i padituri ka qenë në dijeni për lidhjen e Ujdisë gjyqësore të sipër përmendur, sipas së cilës ,sikundër u theksua më lartë,2/5 e asaj paluajtshmërie i kanë takuar paraardhëses juridike të ëmës së paditëses, F.K,ndaj, nga arsyet e sipërcekura, në pjesën e paluajtshmërisë kontestuese, nuk i ka përmbushur kushtet për fitimin e pronësisë sipas parashkrimit fitues (usucapio) nga neni 28 al.4 të LMMTHPJ-ës, së këndejmi, kjo Gjykatë vlerëson se me të drejtë, nga Gjykatat e instancës më të ulët, është refuzuar kundër kërkesëpadia e të paditurit si e pabazuar.

Për arsyet e sipërpërmendura revizioni i të paditurit-kundër paditësit u refuzua si i pa themeltë, andaj, sipas dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.253/2016 datë 20.10.2016

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha

